



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.47, datë 29.04.2020

**“PËR**

**ZHVILLIMIN E PRONAVE NR.1/921, NR. 1/188 DHE NR. 1/922, ZONA  
KADASTRALE 8250, NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË DHE MIRATIMIN E  
MARRËVESHJES SË SIPËRMARRJES MIDIS BASHKISË TIRANË DHE  
SUBJEKTIT STARTEK SHPK”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 54, shkronja “e/1”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 760, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Tiranë, të disa pronave me vendndodhje në zonat kadastrale 8250, 8240, 8190, 8150”, të ndryshuar, Vendimit nr.53, datë 26.04.2018, të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e procedurës për negociimin me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë e Tiranës nëpërmjet marrëveshjes për pronat në pronësi të saj”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e procedurës dhe raportit përmbledhës të hartuar nga komisioni negociues i Bashkisë Tiranë, në lidhje me propozimin e paraqitur nga subjekti “Startek”shpk, pas kualifikimit si të suksesshëm të propozimit dhe përfundimit të procedurës së negociimit me këtë subjekt zhvillues, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 53/2018, të Këshillit Bashkiak Tiranë.
2. Zhvillimin e pasurisë me nr.1/921, pasurisë me nr. 1/188 dhe pasurisë me nr. 1/922 të ndodhura në zonën kadastrale 8250, në pronësi të Bashkisë Tiranë.
3. Dhënien për zhvillim të pasurive të cituara në pikën 2, të këtij vendimi, në këmbim të përfitimit të 40 % të sipërfaqes ndërtimore në favor të Bashkisë Tiranë.
4. Miratimin e marrëveshjes së sipërmarrjes midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit “Startek” shpk, për përfshirjen në zhvillimin e propozuar prej tyre, të pasurive të lartpërmendura, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.
5. Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, nëse është e nevojshme, të kryejë të gjithë procedurat përkatëse pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për ndarjen e pasurive të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, sipas dokumenteve të planifikimit që do të miratohen nga Bashkia Tiranë.
6. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij për nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes/shkëmbimit midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit zhvillues.

9. Kryetari i Bashkisë të ngrejë grupin e punës për marrjen në dorëzim dhe pasqyrimin në inventarin e pasurive të paluajtshme dhe inventarin financiar të Bashkisë Tiranë sipërfaqet e përfituara nga kjo procedurë zhvillimi.

10. Kontrata përfundimtare që do të nënshkruhet mes palëve, për kalimin e sipërfaqes ndërtimore, regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe çdo shpenzim deri në regjistrimin përfundimtar të sipërfaqeve takuese në favor të Bashkisë Tiranë, paguhet nga subjekti "Startek" shpk.

11. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**KRYETAR**

**TONI GOÇU**

